



Pranuar / Dorezuar Prinjeftu/Prodato Received/Delivery		08.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHCK	4743/2023		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.562/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtare, me Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses,ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.562/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike" *kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.ref:216/2023 i datës 16.03.2023 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II. OBLIGOHET Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta *rishqyrtuar* lëndën e ankuesit

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën Zyrtar i lartë për Trajnim dhe Zhvillim sipas Akt emërimit të datës 16.01.2017, me Vendimin më numër ref.362/2020 të datës 14.07.2020 tw Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), i ipet grada diplomatike Ministër Këshilltar dhe caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë /Republika e Italis me mandat katër (4) vjeçar, duke filluar nga data 01.09.2020.

Më tutje, ankuesi me Vendimin me numër nr.785/2020 të datës 07.10.2020, të Ministres të MPJD-së me gradën Ministër –Këshilltarë autorizohet që për nevoja të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës të ketë qasje në Arkivin e Shtetit të Vatikanit dhe Arkivat e Shtetit të Italisë.

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 16.03.2023 merr Vendim me numër Nr.Ref.216/2023, sipas të cilit ankuesin me gradën diplomatike Ministër Këshilltar, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë/Itali e kthen/tërheq nga misioni diplomatik nga data 01.05.2023.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr.ref:216/2023, te datës 16.03.2023 lidhur me tërheqjen dhe kthimin e tij nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Romë/Itali, me datën 27.03.2023 përmes emailit ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3006/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 30.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje ne ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 07.04.2023 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën,A.nr.562/2023 të datës 27.03.2023 me numër protokolli 3006/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.Ref: 216 i datës 16.03.2023 me numër protokolli 1146 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi me Nr. 785 i datës 07.10.2020 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Përgjigje ne ankesë e datës 07.04.2023 me nr. Protokolli 3988/2023; Vendimi me A.nr. 436/2020 i datës 04.02.2021 i KPMSHCK; Vendimi me A.nr. 473/2022 i datës 26.09.2022 i KPMSHCK; Akt emërimi datës 16.01.2017 me nr.192; Vendimi me Nr. 101/09 i datës 23.11.2009 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi me Nr. 576 i datës 01.11.2016 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi me Nr. ZSP-04/2017 i datës 16.01.2017 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi me Nr. 334 i datës 12.08.2016 i Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimi me Nr. 362 i datës 14.07.2020 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi me Nr. ZSP-106/2016 i datës 13.09.2017 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi me Nr.Ref: 023/2016 i datës 29.01.2016 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi me Nr. 009 i datës 09.01.2014 i Ministrit të Punëve të Jashtme; Formular për vlersimin e rezultateve në punë i vitit 2023; Vendimi me Nr.Ref: 067/2016 i datës 07.03.2016 i Zëvendës Ministrit të Punëve të Jashtme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankueses të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* duke e obliguar Zëvendës Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë rishqyrtimin e Vendimit me numër Nr.ref:216/2023, të datës 16.03.2023, përmes të cilit ankuesi është kthyer/tërhequr nga misioni diplomatik ,SEPSE :

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Nr.ref:216/2023, të datës 16.03.2023, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm e plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren (QRK) Nr.04/2014 dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 16.03.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.ref:216/2023 përmes të cilit, *me gradën diplomatike Ministër Këshilltare në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë/ Republika e Italisw, tërhiqet / kthehet nga misioni, për nevoja të punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa në paragrafin II të këtij vendimi citoj „ Kthimi i z. Destani i shprehur si në pikën e 1 të këtij vendimi behet me datën 01.05.2023”, andaj Kolegji vlerëson se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka arritur të arsyetojë vendimin siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: “Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret”, poashtu nuk ka arritur të sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i atakuar përmes kësaj ankese, respektivisht të sqarojë në mënyrë të hollësishme shkaqet se për çfarë arsye bëhet kthimi i ankuesit nga misioni diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, po ashtu nuk ka arritur të arsyetojë Vendimin në fjalë sepse në rastin konkret kanë qenë të pazbatueshme dispozitat e nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se mungesa e arsyesimit të pamjaftueshëm të Vendimit numër Nr.ref.216/2023 nga ana Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është e barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 2 i cili përcakton se: “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.ref.216/2023 i datës 16.03.2023, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1,1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafin 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi i lartë cekur përmban vetëm formulime të përgjithshme por mungon arsyetimi me i detajuar mbi shpjegimin e situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare mbi të cilën është marrë vendimi për kthimin e tij për nevoja të punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, respektivisht nuk kemi asnjë prove me të cilën dëshmohej dhe arsyetohen shkaqet se pse ankuesi është dashur të kthehet për nevojat e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, para përfundimit të mandatit .*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Vendimi me numër Nr.ref:216/2023 i datës 16.03.2023 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave administrative është i kundërligjshëm siç e përcakton Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku thuhet se : *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”*, andaj, nisur nga konstatimi i mësipërm, Kolegji vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin me numër Nr.ref.216/2023 të datës 16.03.2023 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe poashtu edhe për faktin se përmes këtij akti administrativë nuk është qartësuar çështje e vendimeve të mëparshme që kanë qenë në fuqi në lidhje me ankuesin dhe mbi këto arsye të specifikuara më lartë ekziston bazë e mjaftueshme ligjore që lënda e ankuesit në lidhje me vendimin për tërheqjen/kthimin nga misioni diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të kthehet në rishqyrtim me qëllim të vendosjes konform legjislacionit në fuqi që rregullon këtë çështje.

Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje tek organi i njëjtë, gjegjësisht Ministria e Punëve të Jashtme e cila në procedurë të rishqyrtimit duhet t’i marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe t’i eliminoj të metat e konstatuara sipas këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.562/2023.

Vjollca SINANI



Zyrtare e Lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI - BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

